

Thirrja për veprim nga G20 - 2020

QËNDRUESHMËRIA E PRANUESHME DHE GJITHËPËRFSHIRËSE

Kriza e COVID-19 është një thirrje zgjimi për të përshpejtuar tranzicionin në një ekonomi globale më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe për të arritur Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Biznesi dhe Qeveria të dyja kanë role të rëndësishme dhe duhet të ngrihen në këtë rast.

Për qeveritë, kjo nënkupton, për shembull, një ekonomi me mundësi, duke përfshirë diversitetin dhe qasjen në edukim për të gjithë, dhe një ekonomi që mbështet mjedisin tonë, duke përmbytur angazhime thelbësore.

Për biznesin, kjo nënkupton një qasje e integruar, me shumë palë të interesuara në mënyrën se si ata veprojnë dhe qeverisin veten e tyre me një fokus në krijimin e vlerës afatgjatë duke përfshirë parimet e raportimit të integruar.

FOKUSI NË TRANSPARENCËN DHE INTEGRITETIN E SEKTORIT PUBLIK

Krizat nga COVID-19 kanë nxitur një rritje të madhe në shpenzimet e sektorit publik. Tani më shumë se kurrë, integriteti dhe transparenca në sektorin publik janë thelbësore për kontrata sociale ndërmjet qeverive dhe qytetarëve.

IFAC i bën thirrje G20 që të fuqizojë përpjekjet e saj për të ofruar planet e saj të veprimit kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave.

Integriteti i mbështetjes gjithashtu përfshinë një sistem global tatimor të besueshëm dhe një menaxhim të duhur të financave publike. Ai vazhdon me raportime të besueshme të sektorit publik që mbështesin transparencën dhe vendimmarrjen e qëndrueshme afatgjatë. IFAC nxit G20 që të aplikojë kontabilitetin aktual dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik në të gjitha nivelet e qeverisë.

IFAC I BËN THIRRJE G20 TË QËNDROJË E FOKUSUAR NË TË ARDHMEN NDAJ REAGIMIT GLOBAL TË COVID-19 .

Sfidat e ngritura nga COVID-19 janë të papara në epokën moderne; kështu kanë qenë edhe reagimet nga qeveritë e G20. Përqendrimi afatshkurtër në pandeminë ka qenë me të drejtë gjithëpërfshirës. Në të njëjtën kohë, ne nuk duhet të lejojmë që nevojat e menjëhershme të rimëkëmbjes të pengojnë progresin në prioritetet tjera urgjente globale. Jemi në një pikë ndryshimi: të qëndruarit të fokusuar në të ardhmen ndërsa reagojmë ndaj COVID-19 është thelbësore për ekonominë e fuqishme, të qëndrueshme dhe për realizimin e mundësive të shekullit XXI për të gjithë.

REZISTIMI NDAJ FRAGMENTIMIT RREGULLATOR

Fragmentimi rregullator i kushton ekonomisë globale më shumë se 780 miliardë dollarë në vit, dhe kostoja përballohet në mënyrë disproporcionale nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ne thjesht nuk mund të përballojmë kaq shumë humbje.

IFAC u bën thirrje politikë-bërësve në të gjithë G20 që të prioritetizojnë bashkëpunimin dhe harmonizimin në mes rregullatorëve në mënyrë që të gjitha ndërmarrjet të mund të zhvillohen dhe të forcojnë mekanizmat për dialog të vazhdueshëm dhe sistematik ndërkufitar ndërmjet rregullatorëve kombëtar për të përmirësuar konsistencën në rregulloret dhe standardet ndërkombëtare.

Rregulloret luajnë një rol kyç në lidhjen e ekonomisë me qëndrueshmërinë. Ne i nxitim të gjithë palët e interesuara të bien dakord për një kornizë globale të raportimit jo-financiar që përfshin parimet e raportimit të integruar.

RI-ANGAZHIMI PËR BASHKËPUNIM GOLBAL

Vija në mes të problemeve lokale dhe globale vazhdon të mjeçullohet; ne jemi në këtë situatë së bashku.

Sfidat me të cilat përballemi janë të gjitha të ndërlidhura. Prandaj, institucionet globale për

bashkëpunim dhe administrimin e krizave - si të sektorit publik ashtu edhe atij privat - janë më të rëndësishme se kurrë. Këto institucione duhet të jenë të shkathëta: kriza tjetër paparë ndonjëherë mund të jetë rreth e qark.

Përderisa krizat ndikojnë tek të gjithë ne, ndikimet e tyre janë të pabarabarta. Multilateralizmi në mbështetje të ndërtimit më të mirë për ata që kanë më shumë nevojë është themeli për qëndrueshmëri globale në të ardhmen dhe një rrugë drejt krijimit të një bote më të ndershme dhe më me prosperitet për të gjithë.

Udhëheqja e G20 duhet të angazhohet të punojë së bashku përmes institucioneve globale për të parashikuar dhe lehtësuar problemet globale të shekullit XXI.